

PERSON Plan Strategjik 2012-2014

PERSON, Centre for Disability Law & Policy, National University of Ireland, Galway, Ireland
P: +353 (0)91 494272 / E: eu.person@nuigalway.ie / W: www.eu-person.com

This project is funded by the
European Union



Partner Organisations



PERSON (Partnership to Ensure Reforms of Supports in other Nations/Partneriteti për të Siguruar Reformën e Përkrahjeve në Shtetet Tjera) është një projekt, objektiva e të cilit është rritja e kompetencave të organizatave të shoqërisë civile (OJQ-ve) në shtetet e Ballkanit, në nivelin regional dhe atë nacional, që në mënyrë strategjike të avokojnë për dhe të monitorojnë reformat të cilat i prekin personat me aftësi të kufizuara intelektuale, kognitive dhe psiko-sociale. Projekti financohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e BE-së, si një Instrument i Ndihmës së Para Aderimit(IPA).

Centre for Disability Law and Policy (Qendra për dhe Ligje dhe Politika të Aftësisë së Kufizuar, CDLP) në NUI Galway në Irlandë është duke bashkërenduar projektin dhe për partnerë ka pesë OJQ lidere. Partnerët e tyre janë Iniciativa për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar Mendore - MDRI-S) në Serbi, Asociacioni për Afirmim Social të Personave me Aftësi të Kufizuara Psiko-Sociale (SHINE) në Kroaci, SUMERO në Bosne dhe Hercegovinë, Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë (ISDY) në Kosovë dhe Iniciativa për të Drejtat e Njeriut në Shëndet Mendor (RUSIHAK) në Turqi. Më shumë informata të detajuara rreth këtyre partnerëve mund të gjeni në fund të këtij dokumenti.

Qëllimi:

Zhvillimi i Planit Strategjik është njëra ndër detyrat kryesore të rrjetit dhe produkti (siç janë Parimet e PERSON) është vendimtar për të garantuar që progresi i qëndrueshëm drejt reformës është duke ndodhur në të gjitha vendet partnere. Nga secili partner pritet që të kontribuojë në formimin e parimeve udhëzuese, dhe të përkthejë parimet rezultuese në gjuhët vendore. Parimet do të shtypen në gjuhën angleze dhe në gjuhët vendore për secilin vend partner dhesi pjesë e strategjisë për avokim to të shpërndahen tek palët nacionale me interes në çështjen.

Qëllimi i dytë i Planit Strategjik të zhvilluar gjatë fazës fillestare është të qartësojë strategjinë për avokim për partneritetin. Secila nga OJQ-të partnere do të kontribuojë në këtë strategji duke hulumtuar gjendjen më aktuale të ligjeve dhe politikave në vendet e tyre përkatëse, duke theksuar mundësitë për reformë, dhe duke identifikuar fuqitë kryesore avokuese të organizatës. OJQ-të mund ta arrijnë këtë në mënyra të ndryshme, përfshirë: përgatitjen e pakos së mjeteve në format të lexueshëm lehtë për vetë avokuesit; sjelljen e rasteve ligjore mbi mohimin e zotësisës veprimi në gjykatat kombëtare dhe regionale; identifikimin dhe mbështetjen e shembujve të praktikave të mira në vendimmarrjen e mbështetur; dhe lidhjen me palët e gjera të interesit (p.sh. profesionistët ligjorë, gjyqësia, ofruesit e shërbimeve, politikanët, etj.)

Përmbajtja:

- A) Parimet udhëzuese për rrjetin që t'i arrijnë reformat përzotësinë e veprimit
- B) Aktivitetet e dizajnuara për të implementuar objektiven e përgjithshme dhe objektivat specifike të projektit.
- C) Produktet dhe rezultatet nga aktivitetet përtë implementuar objektivat e projektit duhet të specifikohen edhe në Planin Strategjik
- D) Pasqyra e OJQ-ve partnere, statusi aktual i ligjeve mbi zotësinë përtë vepruar në vendet partnere, reforma e pritshme dhe shkathtësitë që duhet të zhvillohen nga OJQ-të

A. Parimet udhëzuese

Projekti parasheh dy grupe të parimeve udhëzuese: 1) parimet udhëzuese për të operuar projektin ("Udhëzimet operacionale"), dhe 2) parimet udhëzuese për të arritur reformën zotësinë përtë vepruar ("Parimet PERSON"). Parimet PERSON do të përcaktojnë pikat kyçe që janë esenciale për reformën e ligjit përzotësinë për të vepruar që është konform me normat aktuale të të Drejtave të Njeriut, duke përfshirë ato të përcaktuara në Nenin 12 të CRPD-së (Konventa e Kombeve të

Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara). Udhëzimet operacionale do të themelohen në fillim të projektit dhe do të sigurojnë planin se si do të zbatohet puna e projektit.

Parimet PERSON

Parimet PERSON janë të bazuara në respektin për autonominë, dinjitet, vetë-përcaktim dhe të drejtate personave me aftësi të kufizuara. Nga kjo pikënisje, grupi po zhvillon Parimet PERSON në listë konkrete dhe koncize që do të përdoret për të udhëzuar rekomandimet për reformë të ligjeve për zotësinë për të vepruar në të gjitha vendet partnere. Ato do të ndërtohen mbi normat e të drejtave të njeriut dhe do të përshtaten në kontekstin vendor përkatës të vendeve partnere (p.sh. korniza ligjore dhe mundësitë për reformë). Në mënyrë që të sigurohet përhapja efektive e parimeve, parimet do të jenë në dispozicion në gjuhën angleze si dhe në gjuhët e vendeve partnere. Ato po ashtu do të kenë për qëllim të shërbejnë si mjet për projektet për reformë në të ardhmen në Bashkimin Evropian, por edhe në botë.

Parimet në vijim janë një pikënisje për projektin PERSON dhe mund të përmirësohen dhe kompletohen përgjatë një procesi të bashkëpunimit të partnerëve gjatë fazave fillestare të projektit. Përveç kësaj, secili nga vendet partnere që merr pjesë në PERSON, mund të dëshirojë të formulojë njëgrup më specifik të parimeve për të udhëzuar proceset e reformimit vendor në vendet e tyre, duke përdorur grupet vendore të ekspertizës dhe të palëve të tjera me interes.

ParimetPERSON përReformën e Ligjit për Zotësinë për të Vepruar

Preambula

Këto parime kanë për qëllim të demonstrojnë masa konkrete të cilat shtetet mund t'indërmarrin për të zbatuar modelin mbështetës për zotësinë për të vepruar të përcaktuar në Nenin 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Edhe pse zotësia për të vepruar prekë në një mori të ligjeve të cilat mund të kenënevojë për reformë (ligji penal, pëlqimi për trajtim, ligji mbi familjen, ligji mbi pronën, etj.), fokusi kryesor i projektit PERSON është në reformën e regjimeve privuese të zotësisë për të vepruar ose mekanizmat vendimmarrëstë jashtëm sic është kujdestaria për të rritur. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që gjatë gjithë kohës të kemi parasysh marrëdhëniet endërrarura dhe të ndërlihdura të të gjitha të drejtave të njeriut – dhetë pranojmë që reforma më e gjerë, duke përfshirë reformën lidhur me të drejtën për liri, përtë votuar, për martesë, dhe për pëlqim për seks (sa për t'i përmendur disa), duhet gjithashtu të arrihen, dhe do të rrisin gëzimin e barabartë të së drejtës për zotësinë për të vepruar për personat me aftësi të kufizuara.

Meqenëse fokusi kryesor i projektit PERSON është në reformën e regjimeve privuese të zotësisë për të vepruar, sic është kujdestaria për të rritur, këto parime edhe pse të zbatueshme për të gjitha qeniet njerëzore, mund të kenë nevojë për modifikim ose përshtatje në kontekstin e fëmijëve (përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara). Kjo reflektohet edhe në vet gjuhën e Konventës, në Nenin 7(2) për fëmijët me aftësi të kufizuara i cili thotë se në “në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, prioritet kryesor duhet të jetë ajo çfarë është më e mirë për këta fëmijë”, kurse Nenin 12 i shmanget çdo referimi në “çfarë është më e mirë” si një parim udhëzues në vendimet lidhur me ushtrimin e zotësisë për të vepruar. Këto tensione nuk mund të zgjidhen domosdoshmërisht në kontekstin e projektit PERSON, edhe pse përgjatë projektit do t'i kushtohet vëmendje nevojës për përkrahjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në ushtrimin e zotësisë tyre për të vepruar. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të mbështetennë zhvillimin e aftësive për vendimmarrje që do t'i përgatisë ata për të ushtruar zotësinë e tyre për të vepruar kur ata të arrijnë moshën madhore në vendet e tyre.

1. Duhet të zhdokumentë gjitha regjimet e vendimmarrjes nga institucioni i kujdestarisë, përfshirë edhe kujdestarinë e pjesshme.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Vëzhgimet Përmbyllëse mbi Nenin 12, vazhdimisht ka përsëritur se Shtetet Palë duhet t'i “rishikojnë ligjet që

lejojnë kujdestarinë dhe mirëbesimin/trusteeship, dhe të ndërmarrin masa për të zhvilluar ligje dhe politika për **të zëvendësuar** regjimet e vendimmarrjes së zëvendësuar me vendimmarrjes të mbështetur, e cila respekton autonominë e personit, vullnetin dhe preferencat.” Projekti PERSON do të ketë synim të sigurojë se reforma e ligjeve në vendet partnere reflekton në modelin mbështetës të zotësisë për të vepruar siç parashihet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

2. Duhet shfuqizuar të gjitha mohimet e zotësisë për të vepruar, të cilat rezultojnë nga një vlerësim ose perceptim i deficitit në kapacitetin mendor.

Personat me aftësi të kufizuara kanë përjetuar diskriminim në mohimin e zotësisë tyre për të vepruar, në krahasim me persona pa aftësi të kufizuara. Ky lloj i diskriminimit i ka prekur në veçanti personat me aftësi të kufizuara intelektuale, kognitive dhe psiko-sociale. Në shumë vende, zotësia për të vepruar e personit mund të hiqet bazuar në perceptimin e deficitit në kapacitetin mendor (aftësia vendimmarrëse). Neni 12 i CRPD thekson se të gjithë personat me aftësi të kufizuara “gëzojnë zotësi për të vepruar në baza të njëjta me të tjerët.” Kjo do të thotë që aftësia e kufizuar për vendimmarrje nuk duhet të rezultojë me heqjen e zotësisë për të vepruar të individit, edhe atëherë kur heqja është e përkohshme ose që lidhet me ndonjë vendim specifik.

3. Mënyra e komunikimit të një individ nuk duhet të jetë faktor për përcaktimin e zotësisë për të vepruar.

Të gjithë individët komunikojnë në mënyra të ndryshme dhe disa, përfshirë personat me aftësi të kufizuara të vendimmarrjes, mund të komunikojnë në mënyra, të cilat vetëm disa njerëz mund t’i kuptojnë (përfshirë komunikimin joverbal, shenjat, gjestet, dhe gjuhën e trupit). Kjo mund të paraqesë sfida në interpretimin ose zbulimin e vullnetit dhe preferencave të individit lidhur me një vendim të caktuar. Megjithatë, përdorimi i mënyrave jo-standarde, ose jo-konvencionale të komunikimit nuk duhet të jenë faktorë në përcaktimin e nivelit të aftësisë së vendimmarrjes të personit, ose të përdoren si arsye për të mohuar zotësinë për të vepruar të individit.

4. Nevojat e një individ për mbështetje nuk duhet të jenë arsye për ta privuar një person nga zotësia për të vepruar. Disponueshmëria e shërbimeve dhe mbështetjeve sociale nuk mund të kushtëzohen me privimin e zotësisë për të vepruar.

Personat me aftësi të kufizuara intelektuale, kognitive dhe psiko-sociale kanë vuajtur diskriminim të shumëfishtë dhe janë zbatuar standarde të dyfishta krahasuar me persona me aftësi të tjera të kufizuara. Përderisa nevoja e lartë e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara fizike apo edhe shqisore jo gjithmonë çojnë deri tek privimi i të drejtave të tyre, siç është e drejta për punë, një nevojë e tillë e madhe për mbështetje është përdorur kundër personave me aftësi të kufizuar intelektuale, kognitive dhe psiko-sociale për t’i privuar ata nga zotësia e tyre për të vepruar, dhe si pasojë edhe nga të gjitha të drejtat e tyre. Përveç kësaj, në shumë vende ekziston një lidhje e fortë ndërmjet ofrimit të shërbimeve sociale dhe heqjes së zotësisë për të vepruar. Neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara thërret për krijimin e mundësive për njerëzit me aftësi të kufizuara që të jetojnë në komunitet në bazë të njëjtë me të tjerët dhe duhet të lexohet në përputhje me Nenin 12 të së njëjtës Konventë. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë qasjeje në shërbime sociale, dhe kjo e drejtë nuk duhet varet nga privimi i zotësisë për të vepruar, si një parakusht për t’i shfrytëzuar shërbimet e tilla.

5. Mbështetjet për të ushtruar zotësinë për të vepruar duhet të njihen ligjërisht

Neni 12.3 i CRPD të KB kërkon nga Shtetet Palë “t’u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara qasje në lidhje me mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e zotësisë tyre për të vepruar.” Mbështetjet për të ushtruar zotësinë për të vepruar mund të marrin forma të ndryshme. Disa individë thjeshtë mund të kenë nevojë për informata të qasshme, të lehta për t’i kuptuar, lidhur me vendimet. Të tjerët mund të kenë nevojë për më shumë kohë për të marrë vendime, apo mbështetje joformale nga një person i besuar. Mbështetjet formale duhet po ashtu të jenë të disponueshme dhe të njohura ligjërisht. Kjo mund të përfshijë mbështetjen avokuese (psh. vetëavokimin, avokimin e bazuar në përvojë, dhe avokimin e pavarur), mundësia për të planifikuar paraprakisht (psh. direktiva

të dhëna paraprakisht për kujdesin në të ardhmen, e drejta e përhershme e avokatit dhe marrëveshjet për mbështetje formale (p.sh. marrëveshjet për përfaqësim, marrëveshjet për vendimmarrje të mbështetur). Njohja ligjore e mbështetësit(ve) të zgjedhur formalisht nga individit duhet të jetë e disponueshme dhe e qasshme, dhe shteti ka për obligim të mundësojë krijimin e këtyre mbështetjeve, veçanërisht për njerëzit që janë të izoluar dhe mund të mos kenë qasje në mbështetjet që ndodhin natyrshëm në komunitet. Njohja ligjore e mbështetësve duhet të përfshijë edhe një mekanizëm për palët e treta për të verifikuar identitetin e personit mbështetës, e po ashtu edhe një mekanizëm për palët e treta për të sfiduar vendimin e një mbështetësi/eje nëse ai/ajo mendon se mbështetësi nuk është duke vepruar duke u bazuar në vullnetin dhe preferencën e individit.

6.Asistenca në vendimmarrje nuk duhet të ndikojë në asnjë të drejtë tjetër themelore

Përdorimi i asistencës në vendimmarrje nuk duhet të ndikojë në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara që në mënyrë të pavarur të ushtrojnë të drejtat themelore të njeriut të cilat janë të lidhura me identitetin e tyre dhe të drejtën për vetë përcaktim. Kjo veçanërisht vlen për të drejtën për të votuar, të drejtën për t'u martuar (ose për të krijuar një partneritet civil) dhe për të krijuar familje, të drejtat e riprodhimit, të drejtat prindërore, e drejta për të dhënë pëlqim për marrëdhënie intime dhe e drejta për liri. Neni 3 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut u garanton të gjithëve “të drejtën për të jetuar, lirinë dhe sigurinë e personit.” Megjithatë, shumë njerëz me aftësi të kufizuara intelektuale, kognitive dhe psiko-sociale vendosen në institucione rezidenciale ose spitale psikiatrike nga kujdestarët ligjorë kundër vullnetit të tyre ose në mungesë të pëlqimit të informuar. Vendosja e individëve në institucione përkujdesëse nga kujdestarët e tyre është dënues nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila po ashtu në raste të shumta ka theksuar nevojën për të vendosur masambrojtëse procedurale në mënyrë që të shmanget heqja e njëkohshme dhe e lirisë edhe e zotësisë për të vepruar.

7.Të gjitha format e mbështetjes për të ushtruar zotësinë për të vepruar(duke përfshirë forma më intensive të mbështetjes) duhet të bazohen në vullnetin dhe preferencën e individit, e jo në interesin më të mirë të perceptuar/objektiv të personit.

Modeli mbështetës iparaparë në Nenin 12 të CRPD-së të KB-së mund të realizohet në disa mënyra- porcilido model mbështetës në esencë duhet të ketë për qëllim realizimin e vullnetit dhe preferencave të individit. Është ky koncept që e dallon modelin mbështetës nga vendimmarrja e zëvendësuar. Regjimet e vendimmarrjes së zëvendësuar imponojnë një vendimmarrës të jashtëm për një individ të cilit i është mohuar zotësia për të vepruar, ku vendimmarrësi vepron sipas ‘interesave më të mira’ objektive apo të perceptuara të individit, në vend se të veprojë në përputhje me dëshirat e individit. Kur vullneti dhe preferenca e një individit është e panjohur dhe vendimi duhet marrë, modeli mbështetës mund të sigurojë emërimin e një vendimmarrësi të jashtëm. Megjithatë, qëllimi i atij vendimmarrësi do të jetë të zbulojë vullnetin dhe preferencat e individit dhe të veprojë në përputhje me to. Kjo do të thotë se një person mbështetës nuk mundet kurrë të imponohet kundër vullnetit të individit dhe vendimmarrësi si resurs i fundit mund të caktohet atëherë kur vullneti dhe preferencat e individit janë të panjohura, nuk mund të zbulohen, pasi të jenë bërë përpjekje të shumta/kuptimplote për t'i zbuluar ato. Kjo imponon obligim për vendimmarrësit që të zhvillojnë kriter të pastër si edhe metodologji të bazuar në shkencë, në hapat dhe aktivitetet drejt njohjes së vullnetit dhe preferencave të individit. Kjo metodologji duhet të formalizohet ose adoptohet nga autoritetet e nivelit nacional dhe detyrimisht të përdoret nga profesionistët në proceset e vlerësimit të nevojave nëse vendimmarrësi duhet të emërohet si mjete i fundit. Me fjalë të tjera, ‘përpjekjet e rëndësishme’ duhet të kuptohen dhe standardizohen.

Është po ashtu e rëndësishme të dihet se vullneti dhe preferencat e individit mund të ndryshojnë me kohën, dhe mbështetjet për ushtrimin e zotësisë për të vepruar duhet ta reflektojnë këtë. Brenda modelit të përkrahjes, duhet të ketë vend për intervenime emergjente me kohë të limituar dhe më së paku kufizuese, por këto intervenime duhet të jenë të mbrojtura dhe të mbikëqyrura në mënyrë strikte dhe nuk duhet të rezultojnë me humbjene zotësisë për të vepruar. Përdorimi i ndonjë

procedure emergjente duhet të drejtohet drejt rivendosjes dhe rritjes së zotësisë për të vepruar të individit.

8. Personi duhet të ketë të drejtë për të refuzuar mbështetjen ose për t'i dhënë fund procesit të mbështetjes në cilëndo kohë që ai/ajo vendosë.

Është rëndësi fundamendale në procesin e vendimmarrjes së mbështetur që bashkëpunimi ndërmjet personave me aftësi të kufizuara dhe ofruesve të vendimmarrjes së mbështetur, është i bazuar në vullnetin e lirë të personave të fjalë. Asnjë vendim nuk mund të merret me mbështetjen e personit tjetër pa bashkëpunimin e bazuar në vullnet dhe pëlqim të informuar. Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të refuzojnë mbështetjen si tërësi, apo vetëm disa nivele të mbështetjes, ose t'i japin fund formave të këtitilla të mbështetjes në cilëndo kohë që ata vendosin dhe nuk kanë nevojë për të shpjeguar arsyet për vendimet e tilla. Lidhur me Parimin 4, nuk duhet të ketë pasoja ligjore negative të imponuara ndaj personave të cilët refuzojnë mbështetjen në vendimmarrje.

Parimi i njëjtë i pëlqimit të informuar duhet të zbatohet te e drejta e individit për të refuzuar çfarëdo intervenimi shëndetësor, përfshirë trajtimin psikiatrik, edhe kur këto intervenime janë konceptuar si formë e mbështetjes. Sipas Nenit 14 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara “ekzistenca e aftësisë së kufizuar nuk duhet në asnjë rast të justifikojë heqjen e lirisë”; kjo është interpretuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të përfshirë ndalimin e trajtimit të pavullnetshëm psikiatrik.

9. Duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse për të gjitha proceset që lidhen me zotësinë për të vepruar dhe me mbështetjen për të ushtruar zotësinë për të vepruar. Qëllimi i këtyre masave mbrojtëse është që të sigurojnë se vullneti dhe preferencat e personit po respektohen.

Kërkohen dy lloje kryesore të masave mbrojtëse për të zbatuar këtë parim. Së pari, duhet të ekzistojnë masat mbrojtëse për të parandaluar heqjen e zotësisë për të vepruar. Së dyti, masat mbrojtëse për të siguruar që të drejtat e njeriut të personit janë mbrojtur gjatë gjithë procesit të mbështetjes. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duhet të ekzistojë monitorimi i marrëveshjeve për mbështetje. Këto duhet të përfshijnë sisteme kontrollimi dhe balansimi për të siguruar se personi mbështetës është duke reflektuar vullnetin dhe preferencat e individit, dhe nuk është duke imponuar këndvështrimet e veta rreth asaj së cili është interesi më i mirë i individit. Në një model mbështetës të vërtetë nuk është e mundur heqja e zotësisë për të vepruar e individit. Megjithatë, nëse një palë brenda sistemit mbështetës është duke vepruar në mënyrë jo të drejtë, individit mund të rrezikohet ashtu që vullneti dhe preferencat e tij nënvlerësohen, injorohen apo zhvendosen dhe masat mbrojtëse duhet të kenë për qëllim parandalimin e kësaj. Modeli i mbështetjes përqipet të realizojë jo vetëm të drejtën e njohjes së barabartë përpara ligjit, por gjithashtu të drejtën e lirisë nga keqtrajtimi, abuzimi, dhe neglizhenca, si dhe të drejtën për shëndet dhe jetë. Masat mbrojtëse duhet gjithashtu të funksionojnë për të parandaluar eksploatimin dhe abuzimin e individëve që shfrytëzojnë mbështetjet për të ushtruar zotësinë e tyre për të vepruar dhe ndikimin e tepërt nga personat mbështetës ose të tjerët.

10. Të gjitha informatat dhe proceset lidhur me zotësinë për të vepruar mundësitë mbështetëse duhet të jenë të qasshme për individin dhe t'u përgjigjen nevojave të tyre specifike.

Në mënyrë që modeli i mbështetjes të realizohet plotësisht, individët duhet të vetëdijesohen për të drejtat e tyre dhe të kenë mjete për t'i kërkuar dhe zbatuar ato. Kjo do të thotë se informatat për mbështetjet e disponueshme dhe të njohura të cilat mund të përdoren për të ushtruar zotësinë për të vepruar duhet të jenë të qasshme për të gjithë, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu kjo do të thotë se informatat publike në përgjithësi, dhe informatat specifike për të cilat individit mund të ketë nevojë në mënyrë që të marrë një vendim, duhet të jenë në dispozicion në një format i cili do jetë i qasshëm për individin, dhe mund të kuptohet lehtësisht nga ata.

Përveç kësaj, personat mbështetës duhet të kenë qasje në trajnime mbi atë se si të ofrojnë mbështetje në vendimmarrje të cilat plotësojnë nevojat e veçanta të individit – kjo përfshinë mbështetësit formal

dhe joformal. Duhet po ashtu të ketë një autoritet të qasshëm për njerëzit që t'i drejtohen atij kur ka ndonjëkonflikt ose shqetësim sa i përket marrëdhënies së vendimmarrjes së mbështetur.